



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ELIDA TAKE
ADRESA NJESIA ADMINISTRATIVE
NR. 5, RR. TISH DALJA, GODINA NR.
9, NJESIA 1, HYRJA 1
TEL: 0698885621

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 651

Nr. koleksioni: 433

Tirane më 23/06/2025

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 124/2024, datë 19/12/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë



A2025053770046355731

REPUBLICA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Taksa e pulles u pagua

STUDIO NOTERIALE ELIDA H. TAKE

Adresa: rr" Tish Daija" Kompleksi "Kika 2", Godina 9, njesia 1-Tirane

e-mail : elidatake@yahoo.it. Mobil.0698885621

Nr. 651 .rep.nr. 433 .kol.

KONTRATË SHITBLERJE **KUOTASH KAPITALI**

Sot më datë 13.06.2025 (dymijë e njëzet e pese), para meje noterit publik, Elida H.TAKE, anëtar i Dhomës së Noterëve Tiranë, në zyrën time noteriale të ndodhur në rr" Tish Daija" Kompleksi "Kika 2", Godina 9, njesia 1-Tirane, u paraqitën personalisht palët kontraktuese të cilët më kërkuan hartimin e kësaj kontrate në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë", ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar), ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" (i ndryshuar) dhe statutit të shoqërisë "AESKULAP" SHPK, me kushtet e mëposhtme:

PALET

Pala Shitëse:

Shoqëria "AESKULAP" shpk, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) me datë 19.11.2018, me NUIS – L82319006O, me qendër në Tiranë, në adresën Rruga "Dritan Hoxha", (referuar ekstrakt të QKB) – përfaqësuar nga ortaku i vetëm **z. Vasil LLAJO**, shtetas shqiptar, atesia Spiro, amesia Polikseni, lindur me 24.11.1956, ne Sarande e banues ne Tirane (sipas deklaramit të tij), madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit biometrik me nr. personal F61124009B - zotërues 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "AESKULAP" shpk.

Pala Blerëse:

z.Arben HASANI, atesia Sabri, amësia Drita, i datëlindjes 05.09.1956, lindur në Tirane dhe banues në Tiranë, në adresën Tirane, bulevardi "Gjergj Fishta" Pall.E-88, ap.10, (sipas deklaramit të tij), madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit(ID) me numër personal F80905088B.

Kushtet Paraprake

- Pala shitëse Shoqëria "AESKULAP" shpk, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) me datë 19.11.2018, me NUIS – L82319006O, me zyrë qendrore në Tiranë me kapital të regjistruar 100.000,00 (njëqind mijë) lekë - përfaqësuar nga ortaku i vetëm **z. Vasil LLAJO**, është e interesuar të shesë kuotën që ai zotëron në kete shoqëri dhe pala blerëse z.Arben HASANI është e interesuar të blejë këtë kuotë;

Për sa më lart palët bien dakord, për sa vijon:

II. OBJEKTI



2.1 Nëpërmjet kësaj kontrate pala shitëse Shoqëria "AESKULAP" shpk i shet palës blerëse dhe konkterisht z.Arben HASANI , 1 kuotë = 100% të kapitalit që zotëron në shoqërinë "AESKULAP" Shpk.

2.2 Pas regjistrimit të kësaj kontrate në Qendrën Kombëtare të Biznesit, ortak i vetëm i shoqërisë "AESKULAP" do të jetë z.Arben HASANI zotërues i 1 (një) kuote e cila përfaqëson 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "AESKULAP" Shpk.

III. ÇMIMI

3.1 Palët bien dakord që çmimi i shitjes së kuotës, objekt i kësaj kontrate, është 100.000,00 (njëqind mijë)lekë. Çmimi i kontratës do të likuidohet nga pala blerëse z.Arben HASANI direkt në llogarinë bankare të z. Vasil LLAJO, brenda 7 ditëve nga nënshkrimi i kësaj kontrate.

3.2 Për çdo vonesë në pagesën e çmimit, do të aplikohet një interes në masën 10% në vit.

IV. TË DREJTA DHE DETYRIME TË PALËVE

4.1 Pala blerëse dhe/ose personat e caktuar prej saj ka/në të drejtë të ketë akses në të gjithë dokumentacionin juridik, financiar e teknik të shoqërisë "AESKULAP" Shpk.

4.2 Pala blerëse detyrohet të paguajë çmimin e kontratës, brenda afatit të përcaktuar në pikën 3.1 të kësaj kontrate.

V. KALIMI I PRONËSISË

5.1 Palët kanë rënë dakord që kjo kontratë shitblerje kuotash kapitali, të regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), menjëherë pas nënshkrimit të saj dhe z.Arben HASANI do të bëhet ortak i vetëm i shoqërisë "AESKULAP" shpk, duke zotëruar 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

5.2 Nga momenti i regjistrimit të kësaj kontrate në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) pala shitëse, humbet çdo të drejtë pronësie mbi kuotën që ai ka në shoqërinë "AESKULAP" shpk. Tirane.

Kjo kontratë hartohet në 5 (pesë) origjinale në gjuhën shqipe, nga të cilat një qëndron në arkivën noteriale, një origjinal regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe më pas qëndron në zyrën qendrore të shoqërisë dhe nga një origjinal e merr secila palë.

Kjo kontratë pasi iu lexua me zë të lartë palëve nga unë noteri publik, ata më deklaruan që ajo është në përputhje të plotë me vullnetin e tyre të lirë, u nënshkrua prej tyre në praninë time dhe unë noteri e vërtetoj atë në bazë të ligjit.

Ne zbatim të ligjit nr.9887, date 10.03.2008 "Per mbrojtjen e te dhenave personale", une noterja deklaroj se do te ruaj dhe perpunoj te dhenat personale te subjektit te ketij akti, ne menyre te drejte dhe te ligjshme.

PALA SHITËSE
Shoqëria "AESKULAP" shpk Tirane

PALA BLERËSE
Arben HASANI

NOTER
Elida H. TAKE

Elida H. Take